



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052987

Datë: 25.02.2020

Numri i dokumentit: 00855765

P.nr.147/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREK - Departamenti i Përgjithshëm Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Lavdim Bajraktari me procesmbajtësen Rina Mustafa praktikante e kësaj gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit F. A. dhe Sh. A. për veprën penale vjedhja e pyllit të parashikuar nga neni 358 parag.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren Departamenti i Përgjithshëm PP.II nr. 371-11/18 të datës 08.03.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur datë 19.02.2020, në prani të Prokurorit të Shtetit Beqë Shala, dhe të akuzuarit F. A. dhe Sh. A., përfaqësuesit të dëmtuarit M. B., mori dhe publikishtë shpalli, ndërsa me datë 25.02.2020 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

1.I akuzuari F. A. nga i ati Xh. A. dhe e ëma S. e gjinisë A. i lindur me dt.23.11.1996 në fshatin M. komuna Suharekë, ku edhe tani jeton, me numër të letërnjoftimit, ka kryer shkollimin fillor, i papunë, i martuar, i gjendjës së dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar me aktgjykimin e plotëfuqishëm kësaj gjykate me numër P.105/2018 dt. 19.06.2019,

2.I akuzuari Sh. A. nga i ati Xh. A. dhe e ëma N. e gjinisë A. i lindur me dt.11.10.1993 në fshatin M. komuna Suharekë, ku edhe tani jeton, me numër të letërnjoftimit, ka kryer shkollimin fillor, i papunë, i martuar, i gjendjës së dobët ekonomike shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar me aktgjykimin e plotëfuqishëm kësaj gjykate me numër P.105/2018 dt. 19.06.2019.

JANË FAJTOR

Sepse,

Me datë 09.01.2018, rreth orës 14.30 minuta në vendin e quajtur “ G. K.” në Suharekë njesia menagjuese”R.” të pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qellim të vjedhjes me motorsharr presin drunjët e llojit “ahu” me vëllim, të përgjithshëm 4.62 m³, me ç’rast të dëmtuarës Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari komuna Suharekë i ka shkaktuar dëm material.

-me këto veprime ka kryer veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 parag.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082

Gjykata në kuptim të neneve 4,7,17,21,41,43, 46,73,74 358 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK)04/L-082, nenit 365, 450, 463 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (KPPRK) 04/L-123 të akuzuarit:

I G J Y K O N

1.Të akuzuarin F. A. :

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej **200 € (dyqind euro)**, dënim i cili duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej **10 ditësh** duke llogaritur një ditë burg me 20 € (njëzetë euro) të dënimit me gjobë.

2.Të akuzuarin Sh. A.:

ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej **200 € (dyqindë euro)**, dënim i cili duhet të paguhet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë atëherë ky dënim do të zëvendësohet me dënim me burg në kohëzgjatje prej **10 ditësh** duke llogaritur një ditë burg me 20 € (njëzetë euro) të dënimit me gjobë.

Obligohen të akuzuarit F. A. dhe Sh. A. që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumë prej **20 euro**, në emër të paushallit gjyqësor, (secili veç e veç) dhe shumë prej **30 euro**, në emër të taksës për viktimat e krimit, (secili veç e veç) të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të detyruar ligjor.

Të dëmtuarës Drejtoria për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari komuna Suharekë Suharekë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzen PP.II nr. 371-11/18 të datës 08.03.2018, i ka akuzuar F. A. dhe Sh. A., për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit të parashikuar me nenin 358 parag.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, aktakuzë të cilën në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka përfaqësuar prokurori i shtetit Beqë Shala.

Në shqyrtimin gjyqësor me datën 19.02.2020, pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të akuzuarit kanë deklaruar se e kanë kuptuar aktakuzën dhe veprën penale me të cilën akuzohen dhe kanë deklaruar: i akuzuari F. A. ka deklaruar se pranojë fajsinë për veprën penale që akuzohen dhe kërkojnë nga gjykata që të i shqiptohet një dënim më i butë, se janë penduar për veprën penale, gjithashtu i akuzuari B. A. ka deklaruar se se pranojë fajsinë për veprën penale që akuzohen dhe kërkojnë nga gjykata që të i shqiptohet një dënim më i butë, se janë penduar për veprën penale .

Prokurori e Shtetit lidhur me deklarinimin e të akuzuarit për pranimin e fajsisë, ka theksuar se nuk e kundërshton deklarinimin e të akuzuarve për ta pranuar fajsinë për veprën penale që i vihet në barrë, pranimi i fajsisë bëhet pa presion dhe në mbështete në prova që përmban aktakuza.

Gjyqtari vetëm gjykues pas deklarinimit të të akuzuarve dhe prokurorës së shtetit , të dëmtuarës, lidhur me pranimin e fajsisë, ka marrë aktvendim me anë cilit ka pranuar deklarinimin e të akuzuarve për pranimin e fajsisë duke vlerësuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë sipas nenit 248 të Kodit Procedures Penale te Republikës së Kosovës (KPPRK). Pastaj gjyqtari ka vlerësuar se i akuzuari kupton natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi bëhet vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajit mbështete në faktet e qështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Pas kësaj konform dispozitë së nenit 326 par. 4 gjykata kaloi në fjalën përfundimtare, dhe prokurori i shtetit mbeti pranë aktakuzës PP/II nr. 371-11/18 të datës 08.03.2018 ndaj të akuzuarve, dhe theksoi se nga provat që përmban akuza pasi që i akuzuari edhe vetë këtu e pranoi fajsinë u vërtetua se pa mëdyshje dhe në mënyrë të plotë se të njejtë kan kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 para. 1 andaj i propozoj që gjykata të shpall fajtor dhe t'a dënoj sipas ligjit, ndërsa përfaqësuesi i dëmtuarës së Drejtoria për Planifikin, Zhvillim, Bujqësi dhe Pyllatri në Suharekë ka theksuar se e mbështesim fjalën e prokurorit te shtetit, dhe qëndrojmë pranë kërkesës pasurore juridike të cilën do ta realizojmë në kontest civil. I akuzuari F. A. në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata se faktin e pranimin e fajsisë ta merr si rrethanë lehtësuese, se kushtet e vështira ekonomike e kushtëzojnë një gjë të tillë, premtoj gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe dhe te kete parasysh kete në shqiptimin e dënimit. I akuzuari Sh. A. në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata se faktin e pranimin e fajsisë ta merr si rrethanë lehtësuese, se jetojmë në kushte të vështira ekonomike, premtoj gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe gjykata të ketë parasysh kete rrethanë në shqiptimin e dënimit.

Duke u bazuar në deklarinimin e të akuzuarit për ta pranuar fajsinë në tërësi për të gjitha pikat e aktakuzës, gjykata nuk vazhdoi me administrimine provave në këtë çështje penale juridike, dhe vazhdoi me fjalën përfundimtare, pasi që gjykata ka vërtetuar këtë gjendje të pa kontestueshme faktike:

- Se me datë 09.01.2018, rreth orës 14.30 minuta në vendin e quajtur “ G. K.” në Suharekë njesia menagjuese”R.”të pandehurit në bashkëkryerje me dashje dhe me qellim të vjedhjes me motorsharr presin drunjët e llojit “ahu”me vellim, të përgjithshëm 4.62 m3,me ç’rast të dëmtuarës Drejtoria për Planifikin, Zhvillim, Bujqësi dhe Pylltari komuna Suharekë i ka shkaktuar dëm material.

Gjendjen e tillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajsisë nga ana e të akuzuarit si dhe nga provat dhe faktet e pa kontestueshme qe i përmban aktakuza, siç janë;

kallzimi penal me numër 9 dhe 10 te dates 31.01.2018 i Drejtorisë për Planifikim, Zhvillim, Bujqësi dhe Pyllatëri në Suharekë, fletëparaqitja e rojtarit të pyllit A. G. me nr.21/2017 të dt. 11.05.2017.

Nga këto fakte dhe prova të vërtetuara në procedurë nga veprimet e të akuzuarit përmbushën të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e pyllit në bashkëkryerje nga neni 358 parag.1 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK) 04/L-082, të cilën e ka kryer me dashje direkte, me qëllim të vjedhjes kështu që duke përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme përfitim pasuror, duke i prerë drunjët të llojit “Ahu” në pyllin publik pa autorizim veprime këtë realizohen elementet e përgjithshme dhe të veçanta të figurës së kësaj vepre penale, ku të akuzuarit ju shqiptua sanksioni penal si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Gjatë përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata për të akuzuarit pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73,74 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), andaj si rrethanë lehtësuese për të akuzuarit muar faktin se e kan pranuar fajsinë, se ndihen të penduar dhe i kan premtuar gjykates se nuk do të përsërisin asnjëherë këtë vepër penale, se janë të gjëndjës varfër ekonomike, mbajtës i të familjës, të papunësuar, ka qenë bashkëpunues me gjykatën, ndërsa rrethanë rënduese gjykata konstatoi faktin se të akuzuarit janë recidivistë të veprave penale vjedhje pylli në pyjet publike.

Për këtë vepër penale është paraparë dënimi me gjobë ose burg deri në 1 vit, të akuzuarit u gjykuan me dënim me gjobë veç e veç në shumën prej 200 € (dyqind euro), me bindjen se këto dënime janë në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmerisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjesisë penale të akuzuarit dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikojë që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen si dhe të bëjë rehabilitimin e tij si dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës dhe atë të paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në nenin 450 parag. 3 të të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK), ashtu që lartësia e paushallit gjyqësor në shumën prej 20 Euro u caktua duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës penale si dhe gjëndjen financiare të akuzuarit, ndërsa shumën prej 30 euro në emër të viktimave të krimi bazuar në nenin 39 parag.3 të Ligjit mbi Kompenzimin e Viktimave të Krimin nr. 05/L-036.

Vendimin që të dëmtuarës lidhur me kërkesën pasurore juridike për kompenzimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale që i dënuari t’ia kompenzojë dëmin e shkaktuar, gjykata e bazoi në nenin 463 parag. 1 të Kodit të Procedurës Penal të Republikës së Kosovës (KPPRK), pasi që e dëmtuara ka deklaruar se kërkesën pasurore juridike do ta realizojë në kontest civil.

Nga të lartcekurat është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal
P. nr 147/2018 dt. 19.02.2020

Procesmbajtësja
Rina Mustafa

G j y q t a r i
Lavdim Bajraktari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.